



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 17/2 Prot.

Tiranë, më 31.07.2023

V E N D I M

Nr. 151 , Datë 31 . 07 . 2023

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është paraqitur ankesa nr. 04, datë 06.01.2023, e z. Albert Çera kundër Universitetit Bujqësor të Tiranës, në të cilën pretendohet për diskriminim për “çdo shkak tjetër” (për shkak të denoncimit të bërë në prokurori për Universitetin Bujqësor¹).

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna në formularin e ankesës, subjekti ankues, në mes të tjerash informon se: “Nga data 16.07.2016 jam punonjës i Universitetit Bujqësor Tiranë me funksion magazinier në Fermën Didaktike Eksperimentale (FDE). Me datë 29.12.2021 kam firmosur në mirëbesim një tender të zhvilluar për blerjen e plehrave kimike dhe inputet bujqësore për fermën, për të cilën nga Drejtori A.R mu premtua që do të vinin brenda datës 15.01.2022, premtim i cili nuk u mbajt nga drejtori i kësaj ferme. Gjatë kësaj kohe që kërkoja faturën që kisha firmosur në mirëbesim, kam vënë re që në magazinë, punonjës të fermës kishin vjedhur. Pasi e konstatova vura në dijeni drejtorin për këtë fenomen dhe asnjë reagim nga ana e tij. Me datë 19.04.2022 në fermën tonë erdhi Rektori, Administratori dhe një punonjës tjetër dhe gjatë mbledhjes pati debate mes Rektorit dhe Drejtorit të fermës, sepse nuk i pëlqeu situata se si ishte ferma dhe në mes të mbledhjes Rektori pati një debat me mua mbi mënyrën e furnizimit të sektorit të blegtorisë dhe unë i paraqita dokumentet. Pasi Rektori u konsultua me financierin tim dhe ai ra

¹ Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Tiranë në datë 10.09.2022 ka rregjistruar procedimin penal nr. 6199 për veprat penale të parashikuara nga nenet 135 dhe 186 të Kodit Penal.

në dakortësi. Pas kësaj Rektori pati një debat me një nga punëtorët e fermës dhe pas këtyre debateve na komunikoi se së shpejti do të kemi një auditim. Pasi mbaroi mbledhja komunikova me Drejtorin për këtë gjë dhe ai në vend të më ndihmonte më bëri presion për të bërë një tjetër dalje fiktive me sasinë 40 kv NPK dhe më siguroi që ti nuk do të auditohesh sepse kam marrë siguri tek Rektori për këtë gjë. Pas datës 19.04.2022 na njoftuan për një mbledhje në UBT dhe të pranishëm në mbledhje ishte Rektori, Administratori, Drejtoresha e Burimeve Njerëzore dhe u komunikua se do të fillojë procesi i auditimit për periudhën 01.01.2020 deri në datë 31.05.2022. Pasi u larguam sërish i kërkova Drejtorit të më plotësonte faturën e datës 29.12.2021, për të cilën kisha firmosur në mirëbesim. Në fillim të muajit qershor, grupi i auditimit erdhi në fermë dhe më pyetën sipas procesit: “a ke ndonjë problem para se të fillojmë” dhe unë si magazinier kam treguar problemin e plehrave kimike dhe inputeve bujqësore. Grupi i punës mori shënime dhe më premtuan se do ta relatojnë në organet drejtuese të institucionit. Një muaj më vonë me datë 15.07.2022 kam bërë mbledhje me Drejtorin në zyrën e tij dhe gjatë mbledhjes kam kërkuar shpjegim se pse nuk vijnë mallrat për të cilën kam firmosur dhe ai direkt më tha se malli nuk do të vij dhe përgjegjësia e kësaj gjëje e mban ti, se je magazinier. Kam kërkuar në mënyrë miqësore tek Drejtori që të sillte faturën e tenderit dhe ai më tha se nuk do ti sjell dhe pikë. Në këtë periudhë mu komunikua një tjetër inventarizim tek magazina dhe u habita se akoma s’ka dalë relacioni i parë dhe të fillojë i dyti. Refuzova menjëherë dhe pas refuzimit më është komunikuar një takim me Rektorin e institucionit dhe në takim më është thënë se duhet të dorëzosh letrat dhe magazinën se do të kalosh në një detyrë tjetër sepse do të fillohet një proces ristrukturimi. Pas kësaj u paraqita në Drejtorinë e Policisë së Qarkut Tiranë² dhe kam dhënë deklaratën time për këtë situatë. Në ditët në vijim kam nisur punën normalisht dhe me 12.09.2022 kam qenë një javë me raport shëndetësor. Me datë 22.09.2022 ka ardhur një grup tjetër inventarizimi të cilin e kam refuzuar pa e bërë në mënyrë protokollare kundërshtimet e mija dhe me këtë datë janë vulosur magazinat. Kryetari i grupit të inventarizimit ishte dhe anëtar i grupit të auditimit të datës 31.05.2022, për të cilin nuk kishte dalë akoma raporti përfundimtar. Unë refuzova një proces të tillë tendencioz të bërë me Urdhrin nr. 2179, datë 07.09.2022, dhe kam thënë se do bëj një relacion me pretendimet e mija. Relacionit e kisha gati me datë 23.09.2022 dhe po në këtë datë është arrestuar Drejtori i Fermës, Kryetari i Komisionit, një specialist bujqësie pranë kësajferme dhe magazinieri nr. 1 i UBT-së. Pretendimet e mija i kam dorëzuar me datë 23.09.2022 dhe kthimi përgjigjes nga universiteti është bërë me datë 25.10.2022. Me datë 27.09.2022 erdhi komisioni dhe u mbajt një procesverbal për të cilën filloi procesi i inventarizimit. Me datë 17.10.2022 më është dërguar dokumentacioni përfundimtar për inventarizimin e magazinës nr. 2 dhe me datë 25.10.2022, kam marrë një shkresë nga universiteti për përgjigjen e analizës së misrit të kryer me datë 21.10.2022. Me datë 28.10.2022 ka dalë relacioni përfundimtar i grupit të kontrollit të datës 31.05.2022. Me datë 24.10.2022 kam kërkuar një takim sqarues me Rektorin e Universitetit sepse e shikoja se i gjithë procesi është bërë në mënyrë tendencioze për të më larguar nga puna. Me shkresën nr. 2179/10, datë 28.10.2022, kam bërë shkresë universitetit për kundërshtimet e mija, mbi mënyrën se si bëhet

² Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Tiranë në datë 10.09.2022 ka rregjistruar procedimin penal nr. 6199 për veprat penale të parashikuara nga nenet 135 dhe 186 të Kodit Penal, për katër punonjës të Fermës Didaktike Eksperimentale (A.R drejtori, T.B përgjegjësi i sektorit të bujqësisë, R.S specialist në sektorin e bujqësisë dhe A.M magazinier në magazinën qendrore).

inventarizimi në magazinën nr. 2, se e shoh tendencioz dhe kërcënues për vendin e punës, sepse titullari i institucionit i kishte premtuar vendin e punës dikujt tjetër, sepse unë kam folur për tenderin e datës 29.12.2021, për të cilën janë përfshirë dhe Rektori i UBT-së. Me shkresën nr. 3034, datë 21.11.2022, jam njoftuar për zgjidhjen e menjëhershme të kontratës së punës. Me shkresën nr. 3034/3, datë 30.11.2022 kam dorëzuar kundërshtimet e mia. Me shkresat nr. 3449, datë 15.12.2022 dhe nr. 3531, datë 20.12.2022, i jam drejtuar Rektorit të universitetit dhe i kam kërkuar ndihmë për të më mbrojtur nga diskriminimi, por nuk kam marrë përgjigje. Me shkresën nr. 3600, datë 22.12.2022 jam njoftuar për zgjidhjen e menjëhershme të kontratës së punës”.

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit dhe kthimin në vendin e punës³.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Hapat proceduralë të ndjekur nga strukturat përkatëse të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, paraqiten si më poshtë vijojnë:

Pas analizimit paraprak të ankesës, u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33/3 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar. Në këto kushte Komisioneri, filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.

- Me shkresën nr. 17/2, datë 16.01.2023, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka njoftuar dhe kërkuar informacion nga institucionet, për ankesën e bërë nga z. Çera, si dhe kërkuar dokumentacionin si më poshtë:
 - Kopje të dosjes personale të ankuesit. (vendim emërimi, kontrata pune, kopje të Librezës së Punës, masa disiplinore, vlerësim performance të tre viteve të fundit, nëse ka, etj).
 - Kopje të procesverbalit të takimit të zhvilluar mes Rektorit të UBT-së dhe stafit të Fermës Didaktike Eksperimentale, datë 19.04.2022 dhe të takimit në të cilin u komunikua fillimi i procesit të auditimit.
 - Kopje të plotë të procedurës së auditimit në magazinat e Fermës Didaktike Eksperimentale (Urdhri i ngritjes së komisionit, objekti dhe metodologjia e auditimit, raporti final, kundërshtimet e palëve, etj, për të gjitha magazinat).
 - Kopje të plotë të procedurës së inventarizimit në magazinat e Fermës Didaktike Eksperimentale (Urdhri i ngritjes së komisionit, objekti dhe metodologjia e auditimit, raporti final, kundërshtimet e palëve, etj, për të gjitha magazinat).
 - Kopje të plotë të procedurës së ndjekur lidhur me ndërprerjen e marrëdhënieve të punës me ankuesin.
 - Kopje të të gjithë kërkesave/ankesave të bëra për diskriminim nga z. Çera dhe përgjigjet e dhëna nga institucioni.

³ Ankuesi gjatë seancës dëgjimore deklaroi se kërkon kthimin në vendin e punës.

- Informacion nëse është marrë masë disiplinore “Largim nga puna” për punonjës të tjerë, për të njëjtat shkelje si ankuesi, nga data 01.07.2021 deri në datë 31.12.2022. Nëse po, kopje të procedurës.
- Kopje të plotë të procedurës së emërimit të punonjësit që ka zëvendësuar ankuesin.
- Kopje të strukturës dhe organikës së Fermës Didaktike Eksperimentale.
- Kopje të Rregullores së Brendshme dhe të mbajtjes së mallrave në magazinë të Fermës Didaktike Eksperimentale.

Me shkresën nr. 182/1, datë 23.01.2023, Universiteti Bujqësor i Tiranës ka kërkuar kopje të ankesës së z. Çera.

Me shkresën nr. 182/3, datë 15.02.2023, Universiteti Bujqësor i Tiranës, në mes të tjerash informoi Komisionerin se: *“Z. Albert Çera është punësuar pranë UBT-së me Vendimin nr. 23, datë 15.07.2016, në pozicionin si punonjës Magazine në FDE. Në zbatim të kontratës individuale të punës me nr. 3097, datë 31.12.2018, z. Çera në pozicionin e punëmarrësit ka për detyrë kryerjen e detyrave sipas përshkrimit të punës, bashkëlidhur kontratës të firmosur mes palëve. Në zbatim të Strukturës së Fermës Didaktike Eksperimentale të miratuar nga Bordi i Administrimit me nr. 9, datë 16.02.2022, pozicioni i Magazinierit është në Sektorin e Bujqësisë. Me datë 16.05.2022 është mbajtur një mbledhje e thirrur nga Rektori dhe Administratori i UBT-së në vijim të kontrolleve të ushtruara në terren me datë 19.04.2022 dhe me datë 13.05.2022, me qëllim marrjen e masave për problematika të konstatuara sidomos në Sektorin e Blegtorisë. Në përfundim të mbledhjes për shkak të performancës së dobët në punë nga titullarët u propozuan marrja e masave administrative për punonjësit e sektorit të blegtorisë. Në këtë mbledhje ka qenë prezent edhe z. Çera, si pjesë e Sektorit të Bujqësisë, ndaj të cilit nuk u vendos asnjë masë administrative.*

Administratori i UBT-së nëpërmjet Urdhrit nr. 44, datë 27.05.2022, ka ngritur një komision për të kryer kontrollin fizik dhe financiar të veprimtarisë menaxheriale në FDE. Gjithashtu me Vendimin nr. 22, datë 25.07.2022, u ngrit grup pune për hartimin e rregullores së re të FDE-së. Në vijim të informacionit paraparak të paraqitur me datë 03.09.2022, i protokolluar me nr. 1456/7, Komisioni i ngritur me Urdhrin nr. 44, datë 27.05.2022, pasi ka analizuar organizimin dhe funksionimin e FDE-së, ka rekomanduar inventarizimin e magazinës në FDE, me qëllim nxjerrjen e konkluzioneve më të sakta mbi qarkullimin e aktiveve.

Për këtë arsye nëpërmjet Urdhrit nr. 71, datë 07.09.2022, Administratori i UBT-së ka ngritur komision për kryerjen e inventarizimit në Magazinën nr. 2, në FDE në zbatim të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe Kontrollin”.

Në përfundim të inventarizimit të Magazinës nr. 2 në FDE, Komisioni i Inventarizimit ka dorëzuar nëpërmjet shkresës nr. 2179/7, datë 17.10.2022, fletët standarde të inventarizimit të nënshkruara nga komisioni dhe magazinieri në cilësinë e përgjegjësit material, relacionin sqarues si dhe procesverbale të mbajtura me dorë gjatë gjithë procesit të kryer. Nga relacioni i paraqitur rezultuan mungesa në vlerë të konsiderueshme monetare.

Gjithashtu në Raportin Përfundimtar me nr. 1456/11, datë 28.10.2022 të paraqitur nga komisioni mbi kontrollin fizik dhe financiar të menaxhimit të proceseve të punës në Fermën Didaktike Eksperimentale, për artikujt që u kontrolluan në Magazinën nr. 2, rezultuan mungesa.

Pas konsultimit të Raportit Përfundimtar të paraqitur nga Komisioni i Inventarizimit i ngritur me Urdhrin nr. 71, datë 07.09.2022, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financës e Universitetit Bujqësor të Tiranës ka paraqitur një informacion me nr. 2179/12, datë 16.11.2022, në zbatim të pikës 87 të Udhëzimit të Ministrit të Financës nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”, në të cilin sqarohet gjendja kontabël, mungesat dhe tepricat. Mungesat e konstatuara në Magazinën nr. 2, janë në vlerë monetare shumë të konsiderueshme, duke sugjeruar ndjekjen e procedurave ligjore për personin përgjegjës. Nënvizojmë faktin se mungesat e konstatuara nuk përfshijnë mallra/produktin për të cilin z. Çera ka denoncuar pranë Prokurorisë së Tiranës.

Me shkresën nr. 3600, datë 22.12.2022, me lëndë “Njoftim mbi organizimin e takimit punëdhënës-punëmarrës”, Administratori i UBT-së i është drejtuar punonjësit z. Albert Çera, me funksion magazinier pranë Fermës Didaktike Eksperimentale, në mbështetje të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës së Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 153 i tij, si dhe të kontratës individuale të punës midis punëdhënësit dhe punëmarrësit, duke e njoftuar për organizimin e takimit punëdhënës-punëmarrës me datë 28.12.2022, me qëllim dhënien e shpjegimeve rreth shkaqeve të zgjidhjes së menjëhershme të kontratës së punës.

Kjo procedurë u zhvillua në zbatim të diferencave të rezultuara nga inventarizimi i Magazinës nr. 2 në Fermën Didaktike Eksperimentale (të dokumentuar me shkresën nr. 2179/7, datë 17.10.2022) si dhe raportit përfundimtar të kontrollit fizik dhe financiar të menaxhimit të proceseve të punës në FDE, (dokumentuar me shkresën nr. 1456/11, datë 28.10.2022) si dhe verifikimeve nga Drejtoria e Ekonomisë dhe Financës me nr. 3034/6, datë 21.12.2022.

Me datë 28.12.2022, është zhvilluar takimi midis punëdhënësit dhe punëmarrësit, gjatë të cilit u mbajt procesverbali me nr. 3600/2, datë 28.12.2022, i firmosur nga përfaqësuesit e punëdhënësit dhe punëmarrësi. Në këtë takim u shpjeguan shkaqet e pasqyruara me dokumentet përkatëse që vërtetojnë se nga ana e punëmarrësit z. Çera janë shkelur detyrimet kontraktuale. Punëmarrësi ka dorëzuar pretendimet e tij prej 15 fletësh të protokolluara me nr. 3600/2, datë 28.12.2022.

Në përfundim të procedurës së nisur me njoftimin nr. 3600, datë 22.12.2022, pas mbarimit të afatit një javor të takimit të zhvilluar mes punëdhënësit dhe punëmarrësit, duke u bazuar në ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës së Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 144, pika 3, neni 153, pika 1 dhe 2, në ligjin nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 51 dhe 52, Statutin e Universitetit Bujqësor të Tiranës, i miratuar me Urdhrin e Ministrit të Arsimit dhe Sportit me nr. 279, datë 28.07.2021, neni 26 pika 7, germa “r” dhe “y”, Kontratën Individuale të punës, me nr. 3097, datë 31.12.2018, neni 8, pika a) dhe c), neni 9, pika c, Administratori i UBT-së vendosi:

- *Me Vendimin nr. 1, datë 04.01.2023, z. Albert Çera, personel administrativ në kategorinë “Magaznier” pranë Sektorit të Prodhimit Bujqësor në Fermën Didaktike Eksperimentale t'i jepet masë disiplinore “Largim nga puna” për shkelje të parashikuara nga neni 8, pika a) dhe c), për paaftësi profesionale në punën e përshkruar në kontratë dhe në përshkrimin e punës bashkëlidhur saj, duke sjellë si pasojë shpërdorimin e pasurisë së UBT-së. Ndërprerja e marrëdhënieve të punës dhe atyre financiare të kryhen me datë 20.01.2023.*

Një kopje e këtij vendimi është vënë në dispozicion dhe është tërhequr nga z. Albert Çera me datë 04.01.2023. Aktualisht pozicioni i Magaznierit është vakant.

Në vijim të të gjitha procedurave administrative dhe ligjore të parashtruara më lart, duhet të theksojmë se z. Çera ka qenë në dijeni për çdo komision të ngritur, për çdo procedurë të ndjekur, për çdo kontroll të kryer, pasi jo vetëm që ka qenë personalisht prezent por edhe ka firmosur çdo shkresë zyrtare drejtuar tij, si dhe ka firmosur çdo fletë inventari fizik të kryer në magazinë. Gjithashtu duhet të përmendim faktin se Universiteti Bujqësor i Tiranës, në mënyrë të vazhdueshme kërkesave të z. Çera, i është përgjigjur si në rrugë shkresore ashtu edhe në zhvillimin e disa takimeve me titullar dhe përfaqësues të institucionit”.

- *Mbështetur në nenin 33/8, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, për shqyrtimin e mëtejshëm të ankesës, Komisioneri me shkresën nr. 17/9, datë 29.03.2023 njoftoi, palët për zhvillimin e seancës dëgjimore me datë 06.04.2023, për të parashtruar dhe argumentuar në mënyrë të drejtpërdrejtë pretendimet e palëve në proces, si dhe kërkoi kopje e dokumentacionit, si më poshtë:*
 - *Informacion nëse është marrë masë disiplinore “Largim nga puna” për punonjës të tjerë, për të njëjtat shkelje si ankuesi, nga data 01.07.2021 deri në datë 31.12.2022. Nëse po, kopje të procedurës.*
 - *Kopje të shkresës nr. 3034/6, datë 21.12.2022, informacion nga Drejtoria e Financës dhe Ekonomisë.*
 - *Kopje të masave disiplinore të dhëna për punonjësit sipas procesverbalit nr. 1316, datë 16.05.2022.*

Bazuar në nenin 80/1/b të Kodit të Procedurave Administrative dhe Rregullores së Brendshme të Komisionerit, seanca dëgjimore u regjistrua audio dhe përmbajtja e saj do të përdoret si provë gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës.

Seanca u zhvillua në datë 06.04.2023, vetëm me praninë e subjektit ankues, pasi UBT megjithëse kishte marrë njoftim nuk u paraqit në seancën dëgjimore.

Gjatë seancës dëgjimore, ankuesi i qëndroi të njëjtave parashtrime që kishte bërë të njohura gjatë komunikimit shkresor me KMD-në dhe që do të shtjellohen në vijim, gjatë arsyetimit të vendimit.

Me shkresën nr. 182/7, datë 03.04.2023, Universiteti Bujqësor i Tiranës, informoi Komisionerin se: “UBT në cilësinë e palës paditëse, me datë 24.03.2023 ka paraqitur në Gjykatën e Rrethit

Gjyqësor Tiranë, padinë me objekt: “Shpërblimin e dëmit kontraktor të shkaktuar në mënyrë të paligjshme të pasurisë së UBT-së, si dhe dëmin e shkaktuar në formën e fitimit të munguar në vlerën 6.793.323 lekë, me palë të paditur z. Albert Çera”.

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

Ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, në nenin 1 sipërcituar dhe nenin 3/1, parashikojnë se: “‘Diskriminim’ është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”.

Gjatë shqyrtimit të ankesës dhe ndjekjes së procedurës hetimore, Komisioneri në përputhje me ligjin ka kërkuar informacionin e nevojshëm dhe dokumentacionin mbështetës, lidhur me rastin e subjektit ankues, në mënyrë që të mund të vlerësonte me objektivitet pretendimin e tij për trajtim të pa drejtë dhe diskriminues.

Komisioneri ka përmbushur kërkesat e parashikuara në Kodin e Procedurës Administrative, edhe sa i takon dhënies së ndihmës efektive, gjë e cila është përcaktuar në nenin 10, të tij: “Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjendje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur. Ai i informon palët mbi të drejtat dhe detyrimet e tyre, përfshirë të gjithë informacionin e lidhur me procedurën dhe i paralajmëron ato për pasojat ligjore të veprimeve ose mosveprimeve të tyre”.

Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi, i ndryshuar, në nenin 32, pikën 2, të tij ka përcaktuar qartë këtë detyrim, duke cituar se: “Të gjitha institucionet publike dhe subjektet private janë të detyruara të mbështesin Komisionerin, duke i dhënë informacionin që i nevojitet dhe duke i garantuar aksesin në informacionin në përmbushjen e detyrave të tij”.

Si rregull, me qëllimin për të përcaktuar nëse subjekti ankues është trajtuar në mënyrë të padrejtë, të pabarabartë apo të pafavorshme krahasuar me punonjës të tjerë të institucionit/UBT-së, në një situatë të njëjtë apo të ngjashme me të, nevojitet “krahasuesi”. Në rastet dhe kushtet kur ky “krahasues” mungon, Komisioneri vlerëson nëse subjekti ankues është trajtuar në mënyrë të padrejtë e të pafavorshme, në raport me aktet ligjore që normojnë marrëdhënien mes tij dhe punëdhënësit.

A. Lidhur me trajtimin e padrejtë, të pabarabartë dhe të pafavorshëm të ankuesit.

Referuar dokumentacionit të administruar gjatë procesit të hetimit, rezulton se:

Me Vendimin nr. 23, datë 15.07.2016, z. Albert Çera është emëruar në pozicionin “Magaziniere” në Fermën Didaktike Eksperimentale, pranë UBT-së.

Rezulton se mes palëve është lidhur kontrata individuale e punës me kohëzgjatje 2 vjeçare, me nr. 3097, datë 31.12.2018, e firmosur nga z. Albert Çera në cilësinë e punëmarrësit dhe z. Edmond Tërthorja, Administrator i Universitetit Bujqësor të Tiranës, në cilësinë e punëdhënësit. Bazuar në parashtrimet dhe dokumentacionin e sjellë nga palët, nuk rezulton të jetë nënshkruar një tjetër kontratë pune mes palëve.

Neni 21⁴, i Kodit të Punës, në pikën 2, të tij, ka përcaktuar se: *“Kontrata e punës quhet e lidhur kur punëmarrësi pranon kryerjen e një pune ose shërbimi, për një periudhë kohe të caktuar ose të pacaktuar, brenda kuadrit të organizimit dhe sipas urdhrave të punëmarrësit dhe që, në bazë të këtyre rrethanave, kryhet vetëm kundrejt pagesës”*.

Për rrjedhojë, në këto kushte, kemi të bëjmë me një kontratë me afat të pacaktuar, pasi punëdhënësi e punëmarrësi kanë vijuar marrëdhëniet e punës në pozicionin magazinier deri me datë 20.01.2023, kur është bërë ndërprerja e marrëdhënieve të punës mes palëve.

Komisioneri ka vlerësuar dhe analizuar objektin e kësaj ankese, lidhur me pretendimin e ankuesit për largimin e tij nga puna si rezultat i denoncimit të tij të bërë në Prokurori në datë 10.09.2022 kundër Drejtorit të FDE-së, së pari, duke analizuar nëse veprimet e Universitetit Bujqësor të Tiranës janë të drejta, në përputhje me parashikimet ligjore, përsa i takon kontrollit fizik dhe financiar të veprimtarisë menaxheriale në FDE dhe kryerjes së inventarizimit në magazinën nr. 2 të FDE-së, dhe së dyti, nëse konstatohet një gjë e tillë, atëherë Komisioneri vlerëson, nëse ky trajtim lidhet apo jo, me shkakun e pretenduar nga subjekti ankues (kallëzimit të bërë në Prokurori).

Nga aktet e administruara gjatë procedurës së shqyrtimit të ankesës rezultoi se:

Referuar procesverbalit nr. 1316, datë 16.05.2022, rezulton se me datë 16.05.2022 është mbajtur një mbledhje e thirrur nga Rektori dhe Administratori i UBT-së në vijim të kontrolleve të ushtruara në terren me datë 19.04.2022 dhe me datë 13.05.2022, me qëllim marrjen e masave për problematika të konstatuara sidomos në sektorin e blegtorisë, lidhur me moszbatimin e detyrave, përgjegjësive nga ana e këtij sektori, të cilat kanë çuar në një performancë pune shumë të ulët. Në përfundim të mbledhjes për personat përgjegjës për rezultatet dhe performancën shumë të dobët në punë nga ana e Rektorit dhe Administratorit të UBT-së u propozuan marrja e masave disiplinore *“Vërejtje me shkrim”* për punonjësit e sektorit të blegtorisë: R.B, F.S, K.P dhe B.H. Për punonjësit e sektorit të bujqësisë në FDE (sektori ku punon ankuesi) u dha masa e vërejtjes me gojë, si paralajmërim i fundit përpara se të procedohet me masa të tjera të parashikuara në kontratë.

Në pikën 5 të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 *“Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”*, i ndryshuar, përcaktohet se: *“Përgjegjësia e Titullarit të njësisë publike. 5. Titullari i njësisë publike është përgjegjës për miratimin e rregullave specifike dhe procedurave për ruajtjen, mbrojtjen, dhe nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve të njësisë publike në përputhje me kërkesat e këtij udhëzimi”*.

⁴ “Forma e kontratës së punës”.

Bazuar në sa më sipër, Administratori i UBT-së, ka lëshuar Urdhrin nr. 44, datë 27.05.2022 “Për ngritjen e komisionit mbi kontrollin fizik dhe financiar të veprimtarisë menaxheriale në Fermën didaktike eksperimentale”, në të cilin ndërmjet të tjerash ka urdhëruar që kontrolli të përfshijë periudhën nga data 01.01.2020 deri në datë 30.05.2022 dhe për sektorin e prodhimit bujqësor dhe verifikimin e dokumentacionit të daljeve nga magazina dhe si është bërë ndjekja e këtij shpenzimi deri në destinacionin përfundimtar.

Gjithashtu me Vendimin nr. 22, datë 25.07.2022, Administratori i UBT-së ka vendosur ngritjen e grupit të punës për hartimin e rregullores së re të FDE-së.

Me shkresën nr. 1456/7, datë 03.09.2022, Grupi i kontrollit fizik dhe financiar ka hartuar informacionin paraprak, për përmirësimin e situatës mbi organizimin dhe funksionimin e FDE-së, në të cilin ka informuar se duke qenë në përfundim të projekt raportit të kontrollit, për të nxjerrë konkluzione të sakta mbi qarkullimin e aktiveve, duhet të kenë në dispozicion inventarin e magazinës në FDE.

Me Urdhrin nr. 71, datë 07.09.2022, “Për ngritjen e komisionit dhe kryerjen e inventarizimit në magazinën nr. 2 në FDE”, Administratori i UBT-së ka urdhëruar ngritjen e komisionit të inventarizimit vjetor pranë magazinës nr. 2, të përbërë nga 3 anëtarë.

Pas njohjes me urdhrin për kryerjen e inventarizimit, ankuesi në datë 10.09.2022 është paraqitur në Drejtorinë e Policisë së Qarkut Tiranë dhe ka denoncuar veprimin e Drejtorit të FDE-së, lidhur me marrjen në dorëzim të materialeve të prokurimit “Blerje plehra kimikë”, në datë 23.12.2021. Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Tiranë në datë 10.09.2022 ka rregjistruar procedimin penal nr. 6199 për veprat penale të parashikuara nga nenet 135 dhe 186 të Kodit Penal, për katër punonjës të Fermës Didaktike Eksperimentale (A.R drejtori, T.B përgjegjësi i sektorit të bujqësisë, R.S specialist në sektorin e bujqësisë dhe A.M magazinier në magazinën qendrore) dhe në datë 23.09.2022, Prokuroria ka kërkuar masën “arrest me burg” për punonjësit e akuzuar.

Me shkresën e protokolluar me nr. 2179/5, datë 23.09.2022, drejtuar Administratorit të UBT-së, ankuesi ka kundërshtuar kryerjen e inventarit nga ana e komisionit dhe ndërmjet të tjerash ka informuar Administratorin se: “Me datë 29.12.2021 kam firmosur plehrat kimikë dhe inputet bujqësore, për të cilët sot me datë 22.09.2022 ka ngelur një sasi plehrash e konsiderueshme pa ardhur, herë pas here i kam kërkuar drejtorit z. A.R të më sjellë plehrat dhe më ka gënjyer duke më thënë do ti sjell dhe nuk i ka sjellur akoma⁵”.

Referuar dokumentacionit të administruar nga palët, rezulton se ky është komunikimi i parë shkresor në të cilin ankuesi ka vënë në dijeni Administratorin e UBT-së, për mungesën e mallrave në magazinë.

Referuar dokumentacionit të administruar nga palët (procesverbale), rezulton se në datë 27.09.2022, Komisioni në prani të ankuesit ka filluar procesin e inventarizimit të magazinës.

⁵ Administratori i UBT-së, me shkresën nr. 2179/9, datë 25.10.2022, ka kthyer përgjigje ankuesit lidhur me kundërshtimet e parashtruara.

Me shkresën nr. 2179/7, datë 17.10.2022, Komisioni i inventarizimit ka dorëzuar relacionin, në të cilin në përfundim ka informuar se: *“Në zbatim të pikës 4/a, rezultoi se gjendja kontabile me datë 22.09.2022 dorëzuar nga komisioni ishte 29.240.902 lekë, vlera sipas të dhënave të dala nga inventarizimi fizik rezultoi në 22.808.444 lekë, mungesat e dala nga inventarizimi janë në vlerën 6.447.707 lekë, ndërsa tepricat janë 15.248 lekë”*, dhe dokumentacionin (procesverbale dhe fletë inventarizimi) mbi inventarizimin e magazinës nr. 2, të FDE-së, të firmosur nga komisioni dhe nga ankuesi.

Me shkresën nr. 1456/11, datë 28.10.2022, grupi i kontrollit i ngritur ka dorëzuar Raportin përfundimtar mbi kontrollin fizik dhe financiar të menaxhimit të proceseve të punës në FDE.

Në vijim ankuesi me shkresën nr. 2179/10, datë 28.10.2022, ka kundërshtuar mënyrën e procesit të inventarizimit të magazinës dhe për gjetjet e raportit të inventarizimit duke dhënë shpjegimet e tija.

Në zbatim të pikë 87, të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 *“Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”*, i ndryshuar, në të cilën përcaktohet se: *“Nëpunësi autorizues me të marrë dokumentacionin e inventarizimit, nxjerr urdhrin për ndjekje nga nëpunësi zbatues në lidhje me masat për kompensimin dhe sistemimin e diferencave të rezultuara”*, Drejtoria Ekonomike dhe Financës së UBT-së, me shkresën nr. 2179/12, datë 16.11.2022, i ka dërguar Administratorit të UBT-së, informacionin në lidhje me diferencat e relatuara nga inventarizimi në magazinën nr. 2 të FDE-së me përgjegjës material z. Albert Çera. Në këtë informacion Drejtoria Ekonomike dhe Financës në pikën 6 ka informuar se: *“Përsa i përket mungesave⁶ të ndiqen procedurat ligjore”*.

Me shkresën nr. 3034, datë 21.11.2022, Administratori i UBT ka njoftuar z. Çera për organizimin e takimit punëdhënës-punëmarrës në datë 25.11.2022, me qëllim dhënien e shpjegimeve rreth shkaqeve të zgjidhjes së kontratës së punës, si rezultat i diferencave të rezultuara nga inventarizimi i magazinës nr. 2. Referuar procesverbalit nr. 3034/2, datë 25.11.2022, rezulton se në datë 25.11.2022 është zhvilluar takimi mes palëve. Në këtë takim punëdhënësi ka parashtruar se: *“Në dokumentet që ju janë vënë në dispozicion nëpërmjet librit të Dorëzimit të Sektorit të Dokumentacionit, deri në këtë moment rezulton se nga ana juaj si punëmarrës janë shkelur detyrimet kontraktuale”*. Ankuesi gjatë takimit ka parashtruar se pretendimet e tija do ti dorëzoj brenda datës 30.11.2022.

Me shkresën nr. 3034/3, datë 30.11.2022, ankuesi ka dorëzuar parashtrimet e tija, lidhur me shkeljet e konstatuara nga punëdhënësi.

Në vijim të njoftimit për organizimin e takimit lidhur me marrëdhëniet e punës, nuk evidentohen të jenë ndërmarrë hapa të tjerë apo të jetë vijuar më tej me procedurën e iniciuar kundrejt ankuesit nga punëdhënësi deri në datë 22.12.2022.

Me shkresën nr. 3600, datë 22.12.2022, Administratori i UBT ka njoftuar z. Çera për organizimin e takimit punëdhënës-punëmarrës në datë 28.12.2022, me qëllim dhënien e shpjegimeve rreth shkaqeve të zgjidhjes së kontratës së punës, si rezultat i diferencave të rezultuara nga inventarizimi

⁶ Mungesat e relatuara nga Komisioni i inventarizimit janë në vlerën 6.444.287 lekë.

i magazinës nr. 2, si dhe verifikimeve nga Drejtoria e Financës dhe Ekonomisë. Referuar procesverbalit nr. 3600/2, datë 28.12.2022, rezulton se në datë 28.12.2022 është zhvilluar takimi mes palëve. Në këtë takim punëdhënësi ka parashtruar se: *“Në dokumentet që ju janë vënë në dispozicion deri në këtë moment rezulton se nga ana juaj si punëmarrës janë shkelur detyrimet kontraktuale”*. Ankuesi gjatë takimit ka parashtruar se sot me datë 28.12.2022, ka dorëzuar pretendimet e tija.

Me Vendimin nr. 1, datë 04.01.2023 *“Për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës të z. Albert Çera, personel administrativ në kategorinë magazinier në Fermën Didaktike Eksperimentale, pranë UBT-së”*, Administratori i UBT-së ka vendosur që z. Albert Çera ti jepet masë disiplinore *“Largim nga puna”*, për shkelje të parashikuara nga neni 8, pika a) dhe c), për paaftësi profesionale për punën e përshkruar në kontratë, duke sjellë si pasojë shpërdorimin e pasurisë së UBT-së dhe ndërprerja e marrëdhënieve të punës dhe financiare, të bëhet në datë 20.01.2023.

Ankuesi kundërshton arsyen e largimit nga puna dhe pretendon se ndërprerja e marrëdhënieve të punës ka ndodhur për shkak të denoncimit që ka bërë në datë 10.09.2022, kundër Drejtorit dhe disa punonjësve të FDE-së. Në këtë kontekst, sqarimi i fakteve dhe rrethanave në të cilat është marrë vendimi i punëdhënësit për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës me ankuesin, i shërben qëllimit për të gjykuar mbi vërtetësinë e motivacionit të largimit nga puna të deklaruar nga punëdhënësi, si dhe ligjshmërinë e këtij veprimi.

Së pari, Rektori i UBT-së nuk mund të ngarkohet me përgjegjësinë e largimit të ankuesit nga puna, pasi këtë kompetencë bazuar në nenin 51/1 të ligjit nr. 80/2015 *“Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”*, përcaktohet se: *“Administratori i institucionit të arsimit të lartë 1. Administratori është autoriteti më i lartë administrativ dhe përgjegjës për mirëfunksionimin financiar të institucionit. Ai është përfaqësues ligjor i institucionit të arsimit të lartë për çështjet financiare dhe administrative, sipas përcaktimeve të këtij ligji”*, e ka Administratori i UBT-së.

Ankuesi megjithëse ka ngritur disa pretendime kundrejt Rektorit të UBT-së, nuk vuri në dispozicion të Komisionerit prova të drejtpërdrejta/tërthorta të urdhërave të dhëna nga Rektori në drejtim të ankuesit apo prova që Rektori të kishte shtyrë/urdhëruar, në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, Komisionin mbi kontrollin fizik dhe financiar të veprimtarisë menaxheriale në Fermën Didaktike Eksperimentale apo Komisionin për kryerjen e inventarizimit në magazinën nr. 2 në FDE apo ndonjë punonjës tjetër për të ndërmarrë veprime të pafavorshme kundrejt ankuesit. Të gjitha pretendimet e z. Çera kundrejt Rektorit të UBT-së, janë të karakterit deklarativ dhe nuk mbështeten në prova konkrete.

Së dyti, në pikën 5 të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 *“Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”*, i ndryshuar, përcaktohet se: *“Përgjegjësia e Titullarit të njësisë publike. 5. Titullari i njësisë publike është përgjegjës për miratimin e rregullave specifike dhe procedurave për ruajtjen, mbrojtjen, dhe nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve të njësisë publike në përputhje me kërkesat e këtij udhëzimi”*.

Në pikën 73 të udhëzimit të mësipërm përcaktohet se: *“Inventarizimi i aktiveve është një element i rëndësishëm kontrolli në kuadrin e menaxhimit të aktiveve të njësisë, i cili kryhet për të vërtetuar saktësinë, cilësinë e gjendjes fizike të aktiveve në një kohë të caktuar si dhe përdorimin në mënyrën e duhur dhe me eficiencë të tyre. Inventarizimi kryhet nën përgjegjësinë dhe sipas procedurave të miratuara me këtë udhëzim dhe me urdhëra /udhëzime nga titullari i njësisë publike”,* ndërsa në pikën 81 dhe 82, parashikohet se: *“81. Inventarizimi kryhet nga një komision i posaçëm që krijohet me urdhër të Titullarit të njësisë publike ose Nëpunësit Autorizues të çdo niveli të njësisë publike. Lista e aktiveve për inventarizim hartohet nga Nëpunësi Zbatues në bazë të të dhënave të rregjistruara kontabël të aktiveve të njësisë. 82. Komisioni nuk duhet të jetë më pak se 3 punonjës. Anëtarët e komisionit nuk duhet të kenë konflikt interesi. Në komision nuk merr pjesë punonjësi që ka në ngarkim/përdorim aktivin, por ai duhet të jetë i pranishëm kur bëhet inventarizimi dhe, në mungesë të tij, zbatohen kriteret e përcaktuara në paragrafin 13 dhe 14 të këtij udhëzimi”.*

Bazuar në kompetencat që burojnë nga legjislacioni i sipërcituar por dhe nisur nga indiciet e takimit të zhvilluar në datë 19.04.2022 dhe 13.05.2022, Administratori i UBT-së, ka urdhëruar ngritjen e komisionit të kontrollit fizik dhe financiar të FDE-së, në datë 27.05.2022 dhe ngritjen e Komisionit të inventarizimit në datë 07.09.2022. Gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore, ankuesi deklaroi⁷ se: *“Me datë 22.05.2022 ne kemi qenë të njoftuar më përpara për ngritjen e një komisioni për kontrollin fizik dhe financiar të fermës, njoftim i cili është dhënë që në datë 19.04.2022 dhe e kam pritur dhe kam qenë bashkëpunues dhe korrekt me anëtarët e komisionit”.*

Referuar dokumentacionit të shqyrtuar rezulton se ngritja e komisioneve të sipërcituara është bërë përpara se ankuesi të kryente denoncimin në Drejtorinë e Policisë Tiranë në datë 10.09.2022. Gjithashtu, rezulton se ankuesi me shkresën nr. 2179/5, datë 23.09.2022, për herë të parë ka vënë në dijeni Administratorin e UBT-së, lidhur me situatën e mungesës së mallrave plehrave kimikë dhe inputeve bujqësore në magazinë, për të cilin kishte bërë dhe denoncimin në polici.

Së treti, në zbatim të pikës 81 dhe 82 të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 *“Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”,* Komisioni i inventarizimit në prani të ankuesit, ka kryer inventarin e magazinës nr. 2, në të cilën ka evidentuar mangësitë në magazinë⁸. Në vijim, në zbatim të pikës 87, të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 *“Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”,* i ndryshuar, në të cilën përcaktohet se: *“Nëpunësi autorizues me të marrë dokumentacionin e inventarizimit, nxjerr urdhrin për ndjekje nga nëpunësi zbatues në lidhje me masat për kompensimin dhe sistemimin e diferencave të rezultuara”,* Drejtoria Ekonomike dhe Financës së UBT-së, me shkresën nr. 2179/12, datë 16.11.2022, i ka dërguar Administratorit të UBT-së, informacionin në lidhje me diferencat e raportuara nga inventarizimi në magazinën nr. 2 të

⁷ Referuar deklaramëve të ankuesit, min: 12.40.

⁸ Referuar pikës 86 të Udhëzimit 30/2011, personat e ngarkuar për kryerjen e inventarizimeve mbajnë përgjegjësi sipas rastit, përgjegjësi disiplinore, materiale a penale për moskryerjen me saktësi të inventarit.

FDE-së me përgjegjës material z. Albert Çera. Në këtë informacion Drejtoria Ekonomike dhe Financës në pikën 6 ka informuar se: *“Përsa i përket mungesave⁹ të ndiqen procedurat ligjore”*.

Në vijim, UBT në cilësinë e palës paditëse, me datë 24.03.2023 ka paraqitur në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, padinë me objekt: *“Shpërblimin e dëmit kontraktor të shkaktuar në mënyrë të paligjshme të pasurisë së UBT-së, si dhe dëmin e shkaktuar në formën e fitimit të munguar në vlerën 6.793.323 lekë, me palë të paditur z. Albert Çera”*.

Komisioneri vlerëson se, UBT është organi vendimmarrës kompetent lidhur me shqyrtimin e vlerësimit e pretendimeve të ankuesit lidhur me saktësinë dhe ligjshmërinë apo jo të veprimeve të strukturave të UBT-së, përsa i takon ngritjes, përbërjes dhe konkluzioneve të këtyre Komisioneve dhe në përfundim do jetë Gjykata institucioni që do vlerësojë dëmin e shkaktuar apo jo, nga ana e z. Albert Çera.

Së katërti, Komisioneri vlerëson se, marrëdhëniet kontraktuale ndërmjet punëdhënësit/UBT-së dhe punëmarrësit/ankuesit, i nënshtrohen përcaktimeve të akteve ligjore dhe nënligjore që normojnë këtë marrëdhënie. Në këtë kontekst, Komisioneri ka analizuar bazën ligjore në të cilën është mbështetur punëdhënësi, kur ka justifikuar ndërprerjen e menjëhershme të marrëdhënieve të punës me subjektin ankues.

Kodi i Punës dhe Kontrata Individuale e Punës, të cilat në kuptim të përcaktimit të detyrimeve dhe gëzimit të të drejtave ndërmjet palëve kontraktuale kanë fuqinë e ligjit, kanë përcaktuar në mënyrë të detajuar rastet se kur jepen masat disiplinore dhe procedurën që duhet ndjekur e zbatuar për dhënien e tyre.

Neni 8, i Kontratës Individuale të Punës¹⁰ ka përcaktuar se, punëdhënësi mund të largojë nga puna punëmarrësin për këto arsye: *“a. Paraqet paaftësi profesionale për punës e përshkruar në kontratë..... c. Kur provohet se shpërdoron pasurinë e UBT-së”*.

Bazuar në dokumentacionin e shqyrtuar, Komisioneri vlerëson se, në zbatim të nenit 144/3¹¹ dhe 153, pika 1 dhe 2¹², të Kodit të Punës, Universiteti Bujqësor i Tiranë ka respektuar procedurën me sa parashikohet në aktet rregulluese për dhënien e masave disiplinore nga punëdhënësi ndaj punëmarrësit.

Në konkluzion të sa më sipër, Komisioneri gjykon se ankuesi nuk është trajtuar në mënyrë të padrejtë apo të pafavorshme, nga ana e UBT-së, pasi, gjetjet dhe konstatimet e bëra nga Komisioni i Inventarizimit janë konform dhe në përmbushje të kompetencave e parashikimeve ligjore.

⁹ Mungesat e relatuar nga Komisioni i inventarizimit janë në vlerën 6.444.287 lekë.

¹⁰ Kontratë e lidhur midis UBT-së dhe ankesit, me nr. 3097, datë 31.12.2018.

¹¹ 3. Zgjidhja njoftohet me shkrim, Brenda një afati nga 48 orë deri në një javë pas takimit. Në njoftimin me shkrim, punëdhënësi përcakton arsyet e zgjidhjes së kontratës, të cilat lidhen me shkaqe të tilla si aftësia, sjellja e punëmarrësit ose kërkesat Operacionale të ndërmmarrjes.

¹² 1. Punëdhënësi e punëmarrësi, në çdo kohë, mund të zgjidhin menjëherë kontratën për shkaqe të justifikuar. 2. Vlerësohen si shkaqe të justifikuar të gjitha rrethanat e rënda që nuk lejojnë, sipas parimit të mirëbesimit, t'i kërkohej atij që ka zgjidhur kontratën, vazhdimin e marrëdhënies së punës.

Për rrjedhojë, në shpjegim të sa më sipër dhe në referencë të nenit 7, pika 1 të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri gjykon se subjekti ankues, nisur nga kushtet e rrethanat objektive të rastit të tij, nuk i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë dhe të pafavorshëm nga ana e UBT-së.

Në mungesë të një trajtimi të tillë, Komisioneri arrin në konkluzionin që nuk kemi të bëjmë me një sjellje diskriminuese nga ana e UBT-së, ardhur për shkak të denoncimit të bërë nga ankuesi në polici.

B. Lidhur me parashtrimin e ankimit për diskriminim¹³ të z. Çera drejtuar punëdhënësit dhe marrjen e masave për shqyrtimin e saj.

Lidhur me sa më lart, evidentohet se:

- Ankuesi me shkresën nr. 3449, datë 15.12.2022, drejtuar Rektorit të UBT-së, në mes të tjerash ka parashtruar se: “...unë sjam armiku i juaj dhe as i institucionit, ju kanë ushqyer gabimisht. Kërkoj të mos diskriminohem nga askush...”.
- Ankuesi me shkresën nr. 3531, datë 20.12.2022, drejtuar UBT-së, në mes të tjerash ka parashtruar se: “... ju bëj me dije se unë vazhdoj të diskriminohem dhe po trajtohem ndryshe nga të tjerët.....”.
- Ankuesi me shkresën nr. 3532, datë 20.12.2022, drejtuar Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, të UBT-së, në mes të tjerash ka parashtruar se: “... arsyeja që po ju shkruaj është se në vendin e punës ku punoj dhe në UBT, shoh një distancim të shumë punonjësve dhe drejtuesve, një distancim i tillë është shumë diskriminues dhe ofendues nga ky institucion dhe për këtë jam i shqetësuar, mibi mënyrën e trajtimit që po më bëhet.... E nderuar Drejtoreshë ju lutem merrni në konsideratë shqetësimin tim sepse po shoh se ky lloj diskriminimi është i qëllimshëm për të më shkaktuar mua një stres të parikuperueshëm dhe uljen e figurës së UBT..... Me shpresën që të trajtohem me dinjitet nga drejtoria juaj, brenda Kodit të Punës dhe ligjet e diskriminimit që janë në fuqi”.

Ligji “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, në nenin 13, pika 1, shkronja c)¹⁴, e tij ka parashikuar se: “Punëdhënësi është i detyruar:

.....t’u përgjigjet efektivisht dhe në përputhje me këtë ligj ankimeve të marra për shkak të diskriminimit të kryer nga punëmarrësit e tij, brenda një muaji nga marrja e tyre”.

Neni 15¹⁵, i LMD-së, i ndryshuar, ka parashikuar se:

“1. Çdo punëmarrës ka të drejtë të ankohet te punëdhënësi, te Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ose në gjykatë, nëse beson se ka pësuar diskriminim. Kjo dispozitë nuk e kufizon

¹³ Deklarim i bërë gjatë seancës dëgjimore, datë 06.04.2023.

¹⁴ Detyrimet e punëdhënësit.

¹⁵ Të drejtat e punëmarrësit.

të drejtën e ankimit në institucione të veçanta, të ngritura pranë sektorëve të ndryshëm të punësimit.

2. Gjatë periudhës së shqyrtimit të ankesës, punëmarrësi ka të drejtë të vazhdojë punën sipas kushteve të kontratës.

3. Punëmarrësi ka të drejtë të marrë informacion në çdo kohë në lidhje me trajtimin e ankesës, si dhe të marrë shpjegime për vendimet e marra nga punëdhënësi, në përgjigje të ankesës së tij, menjëherë pas shqyrtimit.

4. Në rast se punëdhënësi nuk merr masa për të hetuar dhe për të zgjidhur ankesën për diskriminim, punëmarrësi që ka bërë ankesën ka të drejtë ta ndërpresë punën, pa humbur të drejtën e pagës, për aq kohë sa është e nevojshme për t'u mbrojtur nga diskriminimi. Punëmarrësi kthen pagën e marrë, sipas këtij neni, në rast se diskriminimi i pretenduar nuk rezulton i vërtetuar me vendim të formës së prerë”.

Në nenin 5/1 të LMD-së, të ndryshuar, parashikohet se: “1. Ndalohet diskriminimi për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe mosmarrja në shqyrtim, sipas rasteve të përmendura në nenin 3 të këtij ligji, e një ankimi ose procedure, si dhe çdo forme tjetër sjelljeje që pengon zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë”.

Gjithashtu në nenin 7/1, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, përcaktohet se: “Çdo çdo veprim apo mosveprim i autoriteteve publike ose personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash, përbën diskriminim”.

Mbështetur në sa më sipër, Komisioneri gjykon se, UBT nuk ka zbatuar parashikimet ligjore të LMD-së lidhur me hetimin dhe shqyrtimin *efektiv* të pretendimit për diskriminim të ankuesit dhe haptazi i ka shkelur ato.

Pretendimi për diskriminim i është parashtruar punëdhënësit nga ankuesi me shkresat e sipërcituara, ndërkohë që vijonte të ishte në marrëdhënie pune me UBT.

Punëdhënësi duhet të kishte hetuar e shqyrtuar këtë pretendim të tij, ndërkohë që rezulton se me datë 04.01.2023, ka urdhëruar lirim të ankuesit nga puna në datë 20.01.2023, pa u shprehur lidhur me pretendimin e ankuesit për diskriminim në marrëdhëniet e punës.

Pra, UBT nuk ka respektuar të drejtën ligjore të ankuesit, pasi LMD përcakton qartë se, gjatë periudhës së shqyrtimit të ankesës, punëmarrësi ka të drejtë të vazhdojë punën sipas kushteve të kontratës.

Në rast se do të kishte ndjekur një procedurë të tillë ligjore të parashikuar shprehimisht në LMD, UBT, duhet të kishte patur në konsideratë njëherësh edhe zbatimin e parimit të kontradiktoritetit, si

një garanci që punëmarrësit duhet t'i ishin krijuar mundësitë që ankesa e tij me pretendim diskriminim, të trajtohej efektivisht nga punëdhënësi.

Në këtë kontekst, UBT duhet të kishte marrë masa konkrete dhe efektive për trajtimin e pretendimeve të ankuesit, sipas parashikimeve ligjore.

Në përfundim për sa më sipër, Komisioneri vlerëson se nga ana e Universitetit Bujqësor të Tiranës nuk është bërë një analizë mbi pretendimet për diskriminim të subjektit ankues.

Në këto kushte, Komisioneri vlerëson se Universiteti Bujqësor i Tiranës, ka përgjegjësinë institucionale për marrjen e masave të nevojshme, për mbrojtjen e punëmarrësve nga diskriminimi në marrëdhëniet e punësimit.

Referuar sa më lart, në analizë të legjislacionit sipërcituar, Komisioneri vlerëson se, mostrajtimi i pretendimit për diskriminim, nga ana e Universitetit Bujqësor të Tiranës, është në shkelje të dispozitave ligjore që rregullojnë e normojnë marrëdhëniet e punës: punëmarrës-punëdhënës.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 5, 7, 32 dhe 33, të ligjit 10221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I:

1. Konstatimin e mosdiskriminimit të ankuesit Albert Çera, në të drejtën për punësim, për shkak të denoncimit të bërë nga ana e Universitetit Bujqësor të Tiranës.
2. Konstatimin e shkeljes së dispozitës së Ligjit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, neni 13, pika 1, germa c, lidhur me mostrajtimin e ankesës për diskriminim të bërë nga z. Albert Çera nga ana e Universitetit Bujqësor të Tiranës.
3. Universiteti Bujqësor i Tiranës, të marrë masa për të rishikuar rregulloret dhe aktet e saj të brendshme në mënyrë që ato të parashikojnë procedura konkrete për trajtimin e ankesave për diskriminim që paraqiten nga punëmarrësi.
4. Universiteti Bujqësor i Tiranës, të marrë masa për të rritur ndërgjegjësimin për ligjin nr. 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, duke e afishuar atë në mjediset e Universitetit dhe të Fermës Didaktike Eksperimentale¹⁶.

¹⁶ Referuar nenit 13/2 të LMD-së, në të cilën parashikohet se: “*Punëdhënësi detyrohet të rrisë ndërgjegjësimin për këtë ligj edhe duke e afishuar atë në mjediset publike të vendit të punës, si dhe të mundësojë kuptimin e plotë të tij me mjetet e veta ose me ndihmën e subjekteve të specializuara*”.

5. Brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja dijani për këtë vendim, Universiteti Bujqësor i Tiranës duhet të njoftojnë Komisionerin, lidhur me masat e marra për zbatimin e këtij vendimi.
6. Në referim të nenit 33, pika 11, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010, “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, moszbatimi i këtij vendimi sjell si pasojë ndëshkimin me gjobë, sipas parashikimeve të pikës 13, të po këtij neni.
7. Kundër këtij vendimi lejohet ankimi në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

*Hartoi: A. Xhindi
Rishikoi: R. Hoxha
Miratoi: V. Bushati
Datë: 14.07.2023*